

AKT THEMELIMI
I Shoqerisene Pergjegjesi te Kufizuar
"SRM SERVICES" sh.p.k.

Ne Tirane, sot me date 05 Janar 2022 (dymijë e njezete e dy), me cilesine e Ortakut Thjemelues:

Aurel Zeneli, atesia Bardhyl, amesia Shpresa, i dtl.02.12.1989, lindur ne Kruje dhe banues ne Tirane, ne adresen: Rr."Ymer Kurti", Nd.8, H.28, Ap.33, shtetas Shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Leternjoftimit me numer 032215933 dhe numer personal I91202047E, redaktoi kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklaroit se me vullnet t^e lire t^e plete e t^e sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin " Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon **Shoqerine Tregtare me Pergjegjesi t^e Kufizuar "SRM SERVICES" sh.p.k..**

KREU I

Neni 1

Krijimi

Shoqeria "SRM SERVICES" sh.p.k., eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi t^e jet^e regjistruar n^e QKB, n^e p^rerputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria "SRM SERVICES" sh.p.k., esht^e nj^e shoq^eri tregtare, e themeluar nga Ortaku i Vetem Aurel Zeneli, i cili mbulon humbjet e shoq^eris^e deri n^e pjesⁿ e pashlyer t^e kontributeve t^e n^enshkruara. Kontributi i ortakut p^rerb^en kapitalin e regjistruar t^e shoq^eris^e.

Ortaku g^ezon kuot^en e tij n^e shoq^eri, n^e p^rerpjess^etim me kontributin q^e ka dh^en^e n^e kapital.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Tirane, Shqiperi, me adresë: Rruga "Nikolla Tupa", Nr 2,Ndertesa nr 4,Kati 1,Tirane, Shqiperi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut te Vetem.

Neni 4

Objekti i veprimitarise

- Investime per pasuri te paluajtshme, tregtim i artikujve te ndryshem, sherbime konsulencje ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave etj.



- Importi, eksporti, shitja me shumice dhe pakice e produkteve tekstile, veshjeve te te gjitha llojeve. Shitja me shumice dhe pakice e mallrave industriale dhe ushqimore. Importi, eksporti, shitja me shumice dhe pakice e pajisjeve elekrike, elektronike, lende te pare per industrine, materiale ndertimi e hidrosanitare, pajisje zyrash, kancelari, pjese kembimi auto e makineri te cdo lloji, pajisje teknologjike.
- Shitja, blerja, dhenia me qira, e pasurive te paluajtshme.
- Transport i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit.
- Menaxhimi i qendrave tregtare, bareve, restoranteve si dhe cdo aktiviteti tjeter me qellim rekreacioni, hotelerie dhe turizmi.
- Shoqeria do te kryeje cdo veprim me qellim marrjen e lejeve, autorizimeve, licencave dhe miratimeve te nevojshme per realizimin e veprimitarive te saj, per te cilat kerkohen keto dokumente administrative.
- Ne fushen e ndertimit; ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore deri ne V kate dhe mbi V kate, ndertime hekurudhore, punime mbi shina dhe traversa, germime dhe punime dheu, punime per prishjen e ndertimeve, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, si dhe mirembajtja e tyre. Punime rifiniture te muratures dhe cdo gje tjeter te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik, inox, xhami etj, si dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Rikonstruksione godinash civile, industriale, bujqesore e ekonomike, veshje fasadash te te gjitha llojeve, termike, dekorative, strukturore etj.
- Punime mermeri te te gjitha llojeve te thjeshte dhe dekorativ. Punime, materiale dhe sherbime te te gjitha llojeve qe jane te ligjshme dhe te miratuara ne legjislacionin shqiptar.

Per kryerjen e aktiviteve te shoqerise se mesiperme per te cilat do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent.

Neni 5 Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,00 lekë.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht ne te holla nga "ortaku i

veter " i shoqerise:

Aurel Zeneli, zoterues i 1 kuote, me vlore te per gjithshme 100,00 Leke, qe perben 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme. Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organii Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

- Ortaku i vetem, vendos për çështje si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9 Administrimi

Administrator i shoqerise eshte z.Aurel Zeneli, atesia Bardhyl, amesia Shpresa, i dtl.02.12.1989, lindur ne Kruje dhe banues ne Tirane, ne adresen: Rr."Ymer Kurti", Nd.8, H.28, Ap.33, shtetas Shqiptar, madhor me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Letermjoftimit me numer 032215933 dhe numer personal I91202047E, i emeruar ne kete detyre per nje afat 5 vjecar me te drejte riparterite.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise.

Neni 10 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) Të përfaqësojë Shoqërinë përpara të gjitha Institucioneve Publike dhe çdo pale të tretë në Shqipëri ose jashtë saj.
- ç) Të nënshkruajë dhe të paraqesë të gjitha dokumentet në lidhje me Shoqerinë, hapjen dhe/ose mbylljen e llogarive bankare në emër të Shoqerisë në çdo valutë, si dhe të nënshkruajë dhe të paraqesë të gjitha dokumentet e venojshme në lidhje me llogaritë bankare të Shoqerisë dhe për të marrë të gjitha veprimet ligjore që lidhen me to.
- d) Të punësojë dhe të shkarkojë stafin.
- e) Të caktojë persona të tretë si avokatë, kontabilistë dhe auditorë tatimore për të kryer operacione për funksionimin normal të Shoqerisë.
- f) Të hartojë dhe të nënshkruajë kontrata me palë të treta në kuadër të aktivitetit të Shoqerisë.
- g) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- gj) përgatisti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- h) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



i) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

j) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrëthanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrëthanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpalija e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11 Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".



Neni 13
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 14
Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemlare ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera te rrejta juridike.

Akti i mesiperm pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i Shoqerise tregtare "SRM SERVICES" sh.p.k., nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

ORTAKU I VETEM

Aurel Zeneli

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Aurel Zeneli", is written above a stylized, swooping blue line that serves as a signature.